



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr. 183/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Multi Business Group”- Prizren, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “BM Group” SH.P.K –Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Zgjerimi i ndriçimit publik në Komunën e Rahovecit” me nr. të prok. 623-19-6571-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Rahovecit, më datë: 06.04.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Multi Business Group”- Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Zgjerimi i ndriçimit publik në Komunën e Rahovecit” me nr. të prok. 623-19-6571-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Rahovecit.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Zgjerimi i ndriçimit publik në Komunën e Rahovecit” me nr. të prok. 623-19-6571-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Rahovecit.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Multi Business Group”- Prizren, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues "Multi Business Group"- Prizren, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 16.03.2020 me nr. 183/ 20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Zgjerimi i ndriçimit publik në Komunën e Rahovecit" me nr. të prok. 623-19-6571-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Rahovecit, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin:1, 7, 59, 60, 64 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 39 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.03.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore. Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 30.03.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Lidhur me pretendimin e OE ankues se Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik i cili nuk i ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit për ofrimin e katalogëve për secilin pozicion sipas përshkrimit të para masës sepse për ndriçuesit rrugor në disa pozicione të para masës që në ankesa janë paraqitur me pikat nr.1, 2, 3 ,4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11, katalogu i ofertës së OE të rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kërkesat sipas dosjes së tenderit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Sa i përket katalogut për trupat ndriçues rrugor, i njëjti katalog është ofruar nga OE fitues me ofertë dhe me vendimet e OSHP të lartpërmendur kjo pjesë është konstatuar se kanë qenë në rregull. Ndërsa është rekomanduar nga vendimet e OSHP-së plotësim të katalogut për materialet e tjera. Megjithatë, eksperti shqyrtues edhe pse nuk është i lëmisë profesionale përkatës ka analizuar katalogun konform pretendimeve të ngritura të cilat krejtësisht janë teknike.

Eksperti shqyrtues në shumicën e këtyre pozicioneve nuk ka arritur të vërej ndonjë mospërputhje të përshkrimit teknik për pozicionet në fjalë në mes të para masës dhe katalogut të OE fitues. Kjo ka ndodhur sepse në ankesë OE ankues nuk i ka paraqitur cilat janë dallimet në mes të përshkrimit të dhënë në para masë dhe katalogut të ofruar.

Operatori ekonomik ankues në mënyrë të përgjithësuar ka thënë se për këto pozicione të para masës nuk janë plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit, pa specifikuar ndryshimin në mes të asaj që është kërkuar në DT dhe asaj që është ofruar nga OE fitues. Ndryshimin që kam vërejtur është psh. të pozicioni i para masës ku kërkohet:

“Xham në pjesën e poshtme të ndriçuesit: Nuk ka”

Ndërsa në katalogun e OE fitues është ofruar ndriçuesi me xham në pjesën e poshtme. Mirëpo ky ndryshim për mendimin e ekspertit shqyrtues nuk paraqet ndonjë efekt esencial që do të dëmtonte Autoritetin Kontraktues. Në bazë të kësaj që sqaruam më lartë eksperti shqyrtues e vlerëson këtë pretendim ankimor pjesërisht të bazuar.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se katalogun që OE fitues e ka dorëzuar të Autoritetit Kontraktues si plotësim i dokumentacionit për materialet e tjera, nuk ka dhënë fare përshkrim sipas para masës të kërkuar në dosjen e tenderit për pozicionet:

- Shirit Tokëzimit FeZn (25)m X(4)m
- Kabllot energjetike NAYY/J
- Gyp fleksibil Ø 63 mm dhe Ø 200 mm dhe për
- Unazat për lidhjen e kabllave gërshetë

Lidhur me këtë ekspert shqyrtues ka këtë mendim. OE i rekomanduar për kontratë, ka dorëzuar katalogët për materialet tjera sipas kërkesës së AK dhe të njëjtit janë të ngarkuar edhe në platformën elektronike të KRPP-së. Eksperti shqyrtues i ka analizuar të gjitha këta katalogë të OE fitues dhe askund nuk ka hasur në ndonjë përshkrim teknik për këto katër pozicione për të cilat ka ngritë pretendim operatori ekonomik ankues.

Tani sa do të jetë ndikimi dhe efekti praktik i mungesës së këtij përshkrimi në katalog për këto elemente, pjesë të para masës eksperti shqyrtues i prokurimit nuk mundet ta vlerësoj sepse është çështje teknike.

Edhe për këto pozicione është dashur operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë të ofroj përshkrim teknik në katalogë. Prandaj ky pretendim ankimorë është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues është pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës, dhe lënda të kthehet në **Rivlerësim**.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 30.03.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues si me poshtë:

From: Prokurimi Rahovec

Sent: Monday, March 30, 2020 1:05 PM

To: OSHP

Subject: RE: 183/20 eksp

Te nderuar,

Ju konfirmojmë pranimin e shkresës dhe ne si AK Komuna e Rahovecit, gjatë shqyrtimit të Raportit të ekspertit shqyrtues të lëndës me nr. 183/20, datë: 20.03.2020, konfirmojmë se ne si AK Komuna e Rahovecit nuk pajtohemi me mendimin e Ekspertit shqyrtues.

Ne si AK e kemi respektuar plotësisht nenin 59 dhe 72 të LPP-së sipas Vendimit të OSHP-së me nr. 777/19 dhe 44/20.

Në bazë të nenit 72 të LPP-së (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë) për plotësimin e dokumentacionit shtesë që lidhet me ofrimin e katalogëve për materialet tjera të paramasës, OE i rekomanduar për kontratë e ka plotësuar këtë pjesë, pasi që ne si AK në bazë të LPP-së dhe RrUOPP-së, gjatë Ri-vlerësimit të aktiviteti të prokurimit kemi ftuar ekspert të jashtëm, në bazë nenit 40.10 të RrUOPP-së ku thotë: AK do të ketë të drejtë që të ftojë ekspertë të jashtëm, ku njohuri të veçanta teknike ose të specializuara janë të nevojshme nga objekti i prokurimit dhe nuk është ndryshe në dispozicion brenda AK. Ekspertët e tillë do të pranojnë me shkrim se ata janë rreptësisht të nënshtruar me dispozitat e nenit 11 të LPP-se në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete afariste.

Ekspert nga jashtë si Kryesues i Komisionit për ri-vlerësim, ka qenë: z. Murat Hoxha – Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës, është i punësuar në Ministrinë e Administratës Publike, në pozitën: Inxhinier projekti – Elektronikë me Automatikë, në Departamenti për Standarde dhe Politika të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare (DSPIMNQ).

Rekomandimi i eksperti të jashtë është ky, po citoj: Në cilësinë e ekspertit të Jashtëm nga fusha e Inxhinierisë elektrike I kamë vlerësuar tri ofertat e OE dhe konstatoj se të tri kompanitë I kanë katalogjet (Kërkesa 6 – referuar pramasës) dhe që të tre OE I plotësojnë specifikat teknike të kërkuara në tender, pra edhe OE – “BM Group Sh.p.k” I cili është ankuar në OSHP e ka katalogun dhe I kanë të gjitha specifikat e plotësuar teknike siç janë kërkuar edhe në paramasë - si kriter kryesor. Gjithashtu të tri ofertat e OE janë vlerësuar dhe në kërkesa tjera kryesore dhe I kanë përmbushur ato. Prandaj z. e Prokurimit Publik të KK

Rahovecit si fitues të shpallë OE "BM Group Sh.p.k" me çmimin më të ulët për kontratën me titull: "Zgjerimi i ndriçimit publik në Komunën e Rahovecit" me nr. Të prokurimit 623-19-6571-5-1-1. Kërkojmë nga OSHP-ja, përkatësisht nga Panelin Shqyrtues në bazë të argumenteve të lartë cekura, të hedhë poshtë ankesa e OE ankues si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues sipas Ligjit të Prokurimit Publik. Ju lutem na konfirmoni pranimin e e-mailit.

Me respekt:

Zyra e Prokurimit Rahovec.

Operatori Ekonomik nuk është deklaruar se pajtohet apo nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 06.04.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 30.03.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

Lidhur me pretendimin e OE ankues se Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik i cili nuk i ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit për ofrimin e katalogëve për secilin pozicion sipas përshkrimit të para masës sepse për ndriçuesit rrugor në disa pozicione të para masës që në ankesa janë paraqitur me pikat nr.1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11, katalogu i ofertës së OE të rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kërkesat sipas dosjes së tenderit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Sa i përket katalogut për trupat ndriçues rrugor, i njëjti katalog është ofruar nga OE fitues me ofertë dhe me vendimet e OSHP të lartpërmendur kjo pjesë është konstatuar se kanë qenë në rregull. Ndërsa është rekomanduar nga vendimet e OSHP-së plotësim të katalogut për materialet e tjera. Megjithatë, eksperti shqyrtues edhe pse nuk është i lëmisë profesionale përkatëse ka analizuar katalogun konform pretendimeve të ngritura të cilat krejtësisht janë teknike.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Multi Business Group"- Prizren se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk ka përmbushur kërkesat e parashikuara në FDT ku është dashur të prezantoj katalogun me listën e artikujve sipas standardeve (paramasës), ku OE ka ofruar dëshmi

vetëm katalogun nga prodhuesi i artikujve që do të ofrohen. Më tej, OE ankues shton se në katalogun e dhënë nga OE "BM GROUP" i rekomanduar për kontratë është paraqitur ndriçuesi rrugor me specifika dhe karakteristika teknike shumë të ndryshme nga ato të kërkuara në paramasën e projektit. Tutje, OE ankues shton: Pikat që ndriçuesi rrugor nuk i plotëson krahasuar me ndriçuesin rrugor të kërkuar me projekt janë si në vijim: ftohësi: baza e ndërtuar nga keramika (pa prani të aluminit), xham në pjesën e poshtme të ndriçuesit: nuk ka, dizajn i hapur i ndriçuesit: ventilim natyral i LED-it..., thjerrëzat: secili çip (qelulë) e LED-it duhet të përmbajë nga një thjerrëz të veçantë dhe të ndarë nga thjerrëzat..., LED modulet: moduli dhe në veçanti secili çip i ndriçuesit duhet të kenë mundësinë që të ndërrohen në vend në rastin e nevojës për servisim, Shtëpiza e ndriçuesit: duhet të jetë e punuar nga alumini i derdhur nën shtypje dhe ta ketë mundësinë e hapjes pa mjete të punës në rastin e nevojës për servisim. Si dhe disa pika tjera të cilat janë parashtruar në ankesë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në shumicën e këtyre pozicioneve nuk është arritur të vërehet ndonjë mospërputhje të përshkrimit teknik për pozicionet në fjalë në mes të para masës dhe katalogut të OE të rekomanduar për kontratë. Kjo ka ndodhur sepse në ankesë, OE ankues nuk i ka paraqitur cilat janë dallimet në mes të përshkrimit të dhënë në para masë dhe katalogut të ofruar. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se operatori ekonomik ankues në mënyrë të përgjithësuar ka thënë se për këto pozicione të para masës nuk janë plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit, pa specifikuar ndryshimin në mes të asaj që është kërkuar në dosje të tenderit dhe asaj që është ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë. Po ashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ndryshimin që kam vërejtur eksperti është te pozicioni i para masës ku kërkohet: "Xham në pjesën e poshtme të ndriçuesit: Nuk ka", ndërsa në katalogun e OE fitues është ofruar ndriçuesi me xham në pjesën e poshtme. Mirëpo, ky ndryshim për mendimin e ekspertit shqyrtues nuk paraqet ndonjë efekt esencial që do të dëmtonte autoritetin kontraktues. Andaj, ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Multi Business Group"- Prizren se OE fitues e ka dorëzuar te Autoritetit Kontraktues si plotësim i dokumentacionit për materialet e tjera, nuk ka dhënë fare përshkrim sipas para masës të kërkuar në dosjen e tenderit për pozicionet: Shirit Tokëzimit FeZn (25)m X(4)m, Kabllot energjetike NAYY/J, Gyp fleksibil Ø 63 mm dhe Ø 200 mm, dhe për Unazat për lidhjen e kabllove gërshetë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë, ka dorëzuar katalogët për materialet tjera sipas kërkesës së AK dhe të njëjtit janë të ngarkuar edhe në platformën elektronike të KRPP-së. Mirëpo, eksperti shqyrtues i ka analizuar të gjitha këta katalogë të OE fitues dhe nuk ka hasur në ndonjë përshkrim teknik për këto katër pozicione për të cilat ka ngritë pretendim operatori ekonomik ankues. Tani sa do të jetë ndikimi dhe efekti praktik i mungesës së këtij përshkrimi në katalog për këto elemente, pjesë të para masës, eksperti shqyrtues nuk ka mundur ta vlerësoj sepse është çështje teknike. Megjithatë, Paneli Shqyrtues sqaron se ekspert nga jashtë si kryesues i komisionit për ri-vlerësim

ka qenë: z. Murat Hoxha – Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës, i cili është i punësuar në Ministrinë e Administratës Publike në pozitën Inxhinier projekti – Elektronikë me Automatikë, në Departamenti për Standarde dhe Politika të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare (DSPIMNQ). Rekomandimi i ekspertit të jashtëm është në cilësinë e ekspertit të jashtëm nga fusha e Inxhinierisë elektrike, i cili ka vlerësuar tri ofertat e OE dhe ka konstatuar se të tri kompanitë i kanë katalogët (Kërkesa 6 – referuar paramasës) dhe që të tre OE i plotësojnë specifikat teknike të kërkuara në tender. Pra, Paneli Shqyrtues sqaron se kryetari i komisionit është ekspert i jashtëm dhe ka konsideruar se OE i rekomanduar për kontratë e plotëson këtë kriter.

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në shkresat të cilat i ka pasur në dispozicion, vlerëson se autoriteti kontraktues ka bërë vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave konform nenit 59 të LPP-së. Po ashtu, AK ka pasur në konsideratë edhe nenin 60 të LPP-së për shkak se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë, dhe njëherit ka plotësuar kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. Gjithashtu, Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Komuna e Rahovecit
- 1x1 OE - "Multi Business Group"- Prizren,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.